

[Shpalljet ▼](#)[Kthehu](#)

#01035

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet: **5 SPECIALISTE LOGJISTIKE**

TITULLI I SHPALLJES "SPECIALIST LOGJISTIKE" NË KUADËR TË CENSIT TE POPULLSISË DHE BANESAVE"

Termet e referencës:

- Siguron informacion dhe kontribon në zhvillimin e planit operacional të logjistikës së Cens 2022.
- Siguron konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale me të cilat bie në kontakt gjatë ushtrimit të detyrave.
- Siguron informacion dhe kontribon në evidentimin e zonave të largta të cens, për të gjithë territorin e qarkut që mbulon.
- Evidentimi ambjenteve të përshtatshme dhe sigurimi i funksionalitetit sipas nevojave të Cens 2022.
- Ndërveprimi me magazinën qendrore Tiranë dhe mbikqyrësve në nivel vendor për bazën materiale në qarkun që mbulon.
- Përcakton grafikun e shërbimeve, zbaton dhe raporton mbi planin operacional të menaxhimit të mjeteve të transportit të përcaktuara në zonën e tij të Cens 2022, në nivel Qarku/Bashkie, plotëson fletë-udhëtimet, etj.
- Realizon transportimin e punonjësve të Njesisë së Cens nivel qarku (PCO) me automjetin e institucionit sipas nevojave dhe planit të miraturar të lëvizjeve.
- Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e automjetit të marrë në ngarkim.
- Zbaton me përpikmëri kërkesat e parashikuara në urdhrat e brendshëm të INSTAT në zbatim të Cens 2022, për përdorimin dhe lëvizjen e automjetit gjatë dhe jashtë orarit zyrtar të punës.
- Zbaton rregullat e përcaktuara për evidentimin e hyrjes dhe daljes së automjetit.
- Ofron mbështetje në zgjidhjen e problematikave të terrenit sipas kërkesave.
- Menaxhon bazën materiale rezervë të planifikuar për qarkun.
- Detyra të tjera të ngarkuara nga Ekipi i Organizimit dhe Logjistikës Cens 2022.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Të ketë kryer minimalisht shkollën e mesme;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi;
- Të ketë njohuri të mira të përdorimit të kompjuterit dhe paketës Office (word, excel);
- Preferohen kandidatët me eksperiencë pune në logjistikë, shpërndarje/transport, operativ magazine dhe të tjera të ngjashme;
- Të ketë aftësi në kuptimin e sfidave të performancës në sektorin e logjistikës;
- Menaxhimi i marrëdhënieve të kontratave në mënyrë efektive;
- Aftësi analitike/raportuese. Kandidatët duhet të kenë aftësi për të analizuar dhe identifikuar proceset me përmirësim të mundshëm;
- Aftësi planifikimi dhe zgjidhjen e problemeve. Të përdor informacionet në kohë reale, për të identifikuar dhe trajtuar çështjet shpejt dhe me efikasitet.
- Të jetë i paisur me "Lejedrejtimi e kategorisë B". Të ketë eksperiencë në drejtimin e automjeteve dhe të njohë shumë mirë territorin e qarkut.
- Të jetë i gatshëm për të lëvizuar me shërbime edhe jashtë orarit të punës.

Informacione të tjera:

Numri i Specialisteve të Logjistikës sipas Qarqeve do të jetë:

Diber - 1

Elbasan - 1

Fier - 1

Vlore - 1

Gjirokaster - 1

Kontraktimi do të jetë për një periudhë 11 muaj.

Përzgjedhja e kandidaturave do të nënshtrohet një procesi testimi / intervistimi

Afati i aplikimit:29.03.2022

Aplikimi realizohet nëpërmjet faqes së Institutit të Statistikave në seksionin e vendeve vakante për pozicionet me kontrata të përkohëshme.